

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 526 Prot.

Tiranë, më 28.072015

VENDIM Nr. 82 datë 15.07.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, **"Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, të datës 15.07.2015, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor të ri "Castrum-i i Vigut në Antikitetin e Vonë"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Gëzim Hoxha dhe Prof. Andreas Oettel (Instituti Arkeologjik Gjerman),

VENDOSI:

- I. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor të ri "Castrum-i i Vigut në Antikitetin e Vonë"**, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Gëzim Hoxha dhe Prof. Andreas Oettel (Instituti Arkeologjik Gjerman), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme për vitin 2015:
 - Një dokumentim më bashkëkohor i mbetjeve të sotme ndërtimore të castrum-it;
 - Servey i hollësishëm brenda kështjellës shoqëruar me disa gërmime kontrolli;
 - Kërkime për mundësisnë e ekzistencës pranë kështjellës të një vicus;
 - Kryerja e një servey në zonat e njohura në prapatokën e castrum-it.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO